



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 346/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Gjakovë, për shkak të vendosjes së posterave në vetura në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e pasafatshme ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë .

Arsyetim

Me datë 11.06.2014 ora 10:37 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AKR në të cilën theksohet se me datën 08.06.2014 në Gjakovë në Qendrën e Votimit QV “Mazllum Këpuska” mbështetësit e subjektit politik AAK janë parë duke lëvizur me automjete ku të vendosur e kishin fotografinë e kandidatit për deputet të Kuvendit të Kosovës Xhafer Zymberi nga subjekti politik AAK. Më tutje ka shtuar se këto veprime të parregullta i ka fotografuar personi Ali Fajashiku nga Gjakova. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës. Në cilësi të provës i ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e pasafatshme

PZAP-i, konstaton se ankesa në fjalë është e pasafatshme, pasi që neni 3.4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, parasheh që *“për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin ankesa duhet të parashtrohet në PZAP brenda 72 orë”* nga shkelja e supozuar, ndërsa ngjarja për të cilin pretendon pala ankuese se fotografia e kandidatit për deputet nga subjekti politik AAK ka qenë e vendosur mbi veturë, dhe se këto veprime i kanë vërejtur me datën 08.06.2014, ndërsa ankesa në PZAP është dorëzuar me datën 11.06.2014 në ora 10:37, çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë prej 72 orë për dorëzimin e ankesës në PZAP. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 3.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe nenit 118.1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 346/2014 më datën 12.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Kshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*